

PROF. ASOC. DR. EDMOND MALAJ

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
edmond.malaj@asa.edu.al

**RRETH MURTAJËS DHE RASTEVE TË SAJ NË TROJET
ILIRO-ARBËRORE E PËRRETH, NGA ANTIKITETI
DERI NË MESJETËN E MESME****Abstrakt:**

Sëmundja e murtajës ishte një armik i padukshëm dhe godiste herë pas here, duke shuar nga faqja e dheut popullsinë e fshatrave dhe të qyteteve, dhe shpeshherë pakësonte në mënyrë drastike edhe popullsinë e një vendi të tërë. Artikulli i mëposhtëm trajton murtajën, një nga problemet më të mëdha për Ballkanin dhe trojet tona, por edhe për popujt e tjerë të Europës. Për murtajën në trojet shqiptare kanë shkruar disa autorë të huaj dhe shqiptarë, si B. Hrabak, K. Kërçiku, P. Xhufi, A. Muhaj etj., por ata janë përqendruar kryesisht në shek. XV dhe në periudhën osmane. Risia e këtij artikulli qëndron pikërisht në faktin se jemi përpjekur të japim të dhëna edhe për periudhën e Antikitetit, Mesjetës së Hershme dhe Mesjetës së Mesme. Për këtë jemi bazuar në literaturë historiografike shkencore dhe në disa dokumente, të cilat, në fakt, janë shumë të pakta për periudhat në fjalë. Ne do të përqendrohemi në disa raste të murtajës në territoret iliro-shqiptare, por edhe në ato të fqinjëve, duke filluar nga Antikiteti e duke përfunduar në shek. XI. Artikulli është ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, na u duk e nevojshme të paraqesim një anamnezë të përgjithshme të sëmundjes, duke i shoqëruar këto të dhëna edhe me shembuj historikë, ndërsa pjesa e dytë do të trajtojë ngjarjet historike në lidhje me goditjet e kësaj sëmundjeje. Ky artikull është hulumtimi ynë i parë për historinë e murtajës në trojet shqiptare dhe do të pasohet edhe nga punime të tjera në të ardhmen.

Fjalë kyç:

Murtajë, Perandoria Romake, Murtaja e Justinianit, Perandoria Bizantine, Iliri, Arbëri, Durrës, Vlorë, Butrint.

Epidemia e murtajes ka shkaktuar shfarosje të mëdha të popullsisë botërore që nga lashtësia¹ dhe vazhdon të shkaktojë viktima edhe sot e kësaj dite.² Kjo epidemi ka ndryshuar strukturën etnike në shoqëri të përziera etnikisht dhe fetarisht, duke shkatërruar brenda një kohe të shkurtër edhe aktivitetet ekonomike, tregtare dhe zejtare të një vendi.³ Në Ballkan ekzistonte zakonisht bindja se “infeksioni vinte thuajse gjithnjë nga jashtë, sidomos nga Lindja, dhe shpeshherë, ndër popullsitë e krishtera kishte paragjyqime se vatra e përhapjes ishte Kostandinopoja, kryeqyteti i “perandorisë së të keqes”.⁴ Prej andej, epidemia përhapej në qendrat e bregdetit epiro-shqiptar drejtpërdrejt ose nëpërmjet qyteteve të ndërmjetme, si Shkupi, Ohri, Kosturi, Selaniku e Janina”.⁵ Në pjesën e parë të këtij artikulli do të trajtojmë shkurtimisht murtajën, duke dhënë një paraqitje me të dhëna thelbësore mbi vetë sëmundjen, ndërsa në pjesën e dytë do të merremi me rastet e kësaj epidemie nga Antikiteti deri në agun e Mesjetës së Vonë (gjysma e dytë e shek. XIII), duke u përqendruar në hapësirën iliro-arbërore dhe duke e zgjeruar këndvështrimin edhe në territoret e popujve fqinjë.

Të dhëna historike dhe shpjeguese rreth murtajes

Murtaja është një sëmundje endemo-epidemike akute që fillon me ethe, dobësi të theksuar, adenopati purulente, shenja pulmonare⁶ ose me hemorragji.⁷ Sëmundja njihet me emra të ndryshëm si: gr. *Δοιμοσ*, lat.

¹ *Encyclopedia of Pestilence, Pandemics, and Plagues*, vol. I (A-M), edited by Joseph P. Byrne (Westport/ Connecticut/ London: Greenwood Publishing Group, 2008), 45.

² Vittori Fattorusso & Otto Ritter, *Vademekum Mjekësor për praktikën klinike*, përkthyer nga Stefan Cilka etj. (Tiranë: Naim Frashëri, 1970), 627.

³ Bogumil Hrabak, “Čuma u Herceg-Novom i na Cernogorskom Promorju u XVI, XVII, i XVIII veku”, në *Boka. Zbornik Radova iz nauke, kulture i Umjetnosti* 15-16 (1984), 115.

⁴ Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVII* (Tiranë: Onufri 2016), 1212.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Profilaksia e sëmundjeve ngjitëse të njeriut*, përktheu Stefan Cilka (Tiranë: Shtëpia botuese e librit politik, 1973), 250.

⁷ Fattorusso & Ritter, *Vademekum*, 627.

*Pestis, Pestilencia, Febris pestilentialis, Pestis boronica, Clades inguinaris, Glandylaria.*⁸ Në shqip, krahas fjalës *murtajë* përdoret edhe fjala *molia*,⁹ si dhe termi *flamë*,¹⁰ që e ka origjinën nga italishtja mesjetare dhe përdorej edhe për sëmundje të tjera ngjitëse. Hahn ka hasur për murtajën edhe një fjalë tjetër “kukudhi”, e përdorur edhe nga grekët, për të cilin mendohej se ishte një demon femëror i verbër, me origjinë nga besëtytnitë e Turqisë së atëhershme.¹¹ Sëmundja transmetohej përmes kontaktit me kafshë ose me të sëmurë të infektuar. Fillimi është akut me ethe dhe me dhimbje etj. Kur murtaja është pulmonare, shfaqen simptoma me dispne (vështirësi në frymëmarrje), kollë, ekspektorat hemorragjik etj.¹² Në rastet e murtajës bubonike, nyjet limfatike zmadhohen dhe sinuset e tyre mbushen me leukocite. Këto simptoma janë përshkruar edhe në burime të ndryshme, si historike ashtu edhe letrare, p.sh. te *Dekameroni* i Bokaços, ku jepen përshkrime të detajuara të sëmundjes.¹³

Inkubacioni i sëmundjes zgjat nga 2 deri në 12 ditë.¹⁴ Bacili që shkakton murtajën quhet *Yersin*.¹⁵ Minjtë ishin rezervuari më i shpeshtë i këtij mikrobi, si dhe ndër përhapësit kryesorë, veçanërisht për murtajën bubonike.¹⁶ Pleshtat, sidomos *pleshti i miut*, largoheshin nga minjtë e ngordhur dhe kalonin te njerëzit, duke depozituar material infektiv në lëkurën e tyre.¹⁷ Infeksioni nuk njuh një imunitet të qëndrueshëm; pra, një

⁸ B. Sheube, “Pest, Bubenpest”, në *Real-Encyclopädie der gesamten Heilkunde, Medicinisch-chirurgisches Handwörterbuch für praktische Aerzte*. Hrsg. von Albert Eulenburg. 3., Auflage. 18. Band. (Berlin/Wien: Urban & Schwarzenberg 1898), 556.

⁹ Bernhard Stern, *Medizin, Aberglaube und Geschlechtsleben in der Türkei* (Berlin: H. Barsdorf, 1903), 264.

¹⁰ Johan Georg von Hahn, *Albanesische Studien* (Jena: Friedrich Mauke, 1854), Heft III, 76; shih edhe *Fjalor i gjuhës shqipe*, redaktor shkencor Jani Thomai, grup autorësh (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006), 280.

¹¹ Hahn, *Albanesische Studien*, 163.

¹² Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628.

¹³ Giovanni Bocaccio, *Il Decamerone*. Testo trascritto (Bolzano: Mori, 2017), 8.

¹⁴ Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628.

¹⁵ Sipas zbuluesit të bakterit të murtajës, Alexandre Émile Jean Yersin (1863-1943). Ole Jørgen Benedictow, *The Black Death, 1346-1353. The Complete History* (Suffolk/New York: Boydell Press, 2004), 10.

¹⁶ *Po aty*, 13.

¹⁷ Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 627.

person mund të infektohet përsëri nga i njëjti tip murtaje,¹⁸ ndryshe nga ç' mendohej më parë.¹⁹ Disa kategori njerëzish, si rrjedhojë e veprimtarisë së tyre, ishin të predispozuar të prekeshin më tepër se të tjerët, p.sh. ushtarët dhe tregtarët kur vizitonin panairët,²⁰ të cilat gjithashtu shpeshherë ishin shkak infektimi për qytete dhe vende të tëra. Si shembull mund të përmendim një panair problematik, të cilit venedikasit i ruheshin shumë. Ky ishte panairi i Moskullurit në Korfuz, ku “grumbulloheshin njerëz që vinin nga një mijë e një vende të ndryshme, me sjellje të huaja dhe barbare, që dyshoheshin se ishin që të gjithë gjysëm të infektuar”.²¹ Murtaja shfaqet në disa lloje, si:

1. *Pesta bubonike*, e cila manifestohet me ethe, marrje mendsh dhe temperaturë të lartë (mbi 40°). Nyjet limfatike enjten, bëhen të dhimbshme dhe qelbëzohen, ndërsa bubonet formohen nga dita e dytë deri në të pestën, duke u shoqëruar me njolla të zeza (*petehie*).²² Këtu po paraqesim edhe një shembull tjetër historik, të sjellë nga historiani P. Xhufi, i cili i referohet një dokumenti të shek. XVII. Në të shkruhet se “në prill 1630, mjekët e karantinës së Korfuzit konstatuan te një tregtar me emrin Zhupan Papuli, i ardhur nga bregdeti epiro-shqiptar, një gjëndër me madhësinë e një veje nën sqetullën e djathtë si dhe disa degëzime të saj poshtë, në kofshë dhe në bark. I sëmurit kishte temperaturë, dhimbje dhe djegie të kokës, tharje të gojës, dridhej i tëri dhe arrinte veçse të belbëzonte”.²³ Disa qytete italiane, morën masa higjienike kundër kësaj sëmundjeje, duke larguar plehrat dhe mbeturinat, si dhe duke izoluar të sëmurët.²⁴

2. *Murtaja e lëkurës* që shoqërohej me kruajtje dhe therje të forta në pjesët e prekura të lëkurës, si dhe me shenja në ngjyrë kafe ose puçrra më të vogla se kokrra e fasules, sidomos rreth belit.²⁵

3. *Pesta pulmonare* që merret si një infeksion në formën e

¹⁸ Sheube, “Pest, Bubenpest”, 565-566.

¹⁹ Në shqip fjala “*ksemoljari*”, nënkuptonte një person që e kishte kaluar murtajën, dhe si rrjedhim, mendonin se, nuk mund të sëmurej. Hahn, *Albanesische Studien*, Heft III, 88.

²⁰ Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1213.

²¹ *Po aty*.

²² Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628.

²³ Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1211.

²⁴ Arno Borst, *Lebensformen im Mittelalter* (Frankfurt am Main: Ullstein 1984), 116.

²⁵ Sheube, “Pest, Bubenpest”, 568; “*Petehie per la vita et sopra la vita*”, Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1211-12.

pneumonisë, me simptoma si dispne dhe kollë, e cila përhapej nëpërmjet kontaktit direkt me të sëmurin dhe ishte shumë vdekjeprurëse.²⁶ Kjo formë e murtajës shfaqej më shpesh se format e tjera dhe i sëmuri vdes brenda 2-5 ditësh.²⁷ Në Mesjetë nuk dihej që murtaja pulmonare ishte shumë infektuese, si dhe fakti se ajo përhapej edhe përmes ajrit.²⁸

4. *Pesta minor (murtaja e vogël)* që mund të avancojë deri në murtajë të vërtetë, është vërejtur kryesisht në ato vende ku më parë, ose më vonë, do të shpërthente murtaja e vërtetë.²⁹

5. *Pesta septicemike* manifestohet me ethe e temperaturë të lartë, të vjella, delir,³⁰ hemorragji difuze dhe zakonisht çon në vdekje brenda 3-4 ditësh.³¹

6. *Pesta meningeale*, e cila manifestohet me meningjit dhe zakonisht shfaqet 10-15 ditë pas pestës bubonike.³²

Sëmundja shpesh konsiderohej si ndëshkim i Perëndisë, si një nga tre **“kamxhikët e Perëndisë”**, (dy të tjerët ishin “karkalecat” dhe “turqit”). Këto tri fatkeqësi konsideroheshin si fshikullime që Perëndia ua dërgonte njerëzve, kur ata e kishin harruar dhe nuk respektonin ligjet e Tij. Në një legjendë sllavo-jugore thuhet se murtaja dërgohej nga vetë Zoti; ajo endej nga një vend në tjetrin dhe kishte formën e një gruaje.³³ Po ashtu, te sllavët e Jugut ekziston edhe legjenda se murtaja dhe vdekja ishin dy motra të të njëjtit brumë: kur njëra lodhet, punën e merr tjetra.³⁴ Njerëzit besonin pa asnjë dyshim se murtaja dërgohej nga Perëndia, dhe në Bibël, në Dhiatën e Vjetër, ka disa pasazhe që e konfirmojnë këtë besim.³⁵

Përveç interpretimit hyjnor ekzistonte edhe një interpretim astrologjik, i përhapur më tepër në rrethet intelektuale. Një shembull i tillë është “ekspertiza për murtajën”, gjatë murtajës së madhe në mesin e

²⁶ John Aberth, *Plagues in world history* (Lanham/ Boulder/ New York/ Toronto/ Plymouth: Rowman & Littlefield Publishers, 2011), 22.

²⁷ Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628; Sheube, “Pest, Bubenpest”, 570.

²⁸ Borst, *Lebensformen*, 116.

²⁹ Sheube, “Pest, Bubenpest”, 571; Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628.

³⁰ Xhufi, *Arbërit e Jonit*, 1212.

³¹ Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628; Aberth, *Plagues*, 22.

³² *Po aty*.

³³ Stern, *Medizin*, 264.

³⁴ *Po aty*, 265.

³⁵ 4. Mose 17, 9-25, 5. Mose 32, 39; 1 Samuel 2, 6, etj., *Bibla*, përktheu dhe shtjelloi dom Simon Filipaj (Ferizaj: Drita, 1994), 190-191, 256, 328.

shek. XIV, e cila përmend edhe Shqipërinë. Kjo ekspertizë ishte kërkuar nga mbreti i Francës dhe ishte përpiluar nga Fakulteti i Mjekësisë në Paris, ku gjatë kulmit të epidemisë në qytet vdisnin rreth 800 banorë në ditë.³⁶

Një tjetër teori astrologjike thoshte se murtaja shkaktohej nga zhvendosja e yjeve dhe e planetëve, dhe këtë e besonin edhe mjekët më të njohur të kohës, si p.sh. Gay de Chauliac (shek. XIV) mjeku personal i Papës.³⁷ Po ashtu, besohej se edhe cikli i hënës kishte ndikim mbi përhapjen dhe largimin e murtajës. Sipas këtij besimi, murtaja largohej kur hëna bëhej e plotë.³⁸ Krahas këtyre, kishte edhe interpretime popullore, si ajo se “syri i keq” i të sëmurit mund të infektonte me një vështrim të vetëm, apo se judejtë helmonin puse dhe çezma,³⁹ apo ekzistenca e sëmundjes në formë flakësh, demonësh ose kafshëve që infektonin njerëzit.⁴⁰

Uji i ndenjtur i moçaleve dhe ajri i rëndë konsideroheshin gjithashtu si shkaqe të përhapjes së murtajës, si në rastin e Durrësit, ku besohej se murtaja dhe çdo infeksion tjetër shkaktoheshin nga ajri i rëndë që përhapej nga kënetat. Për këtë arsye, qysh në vitin 1393, u hartuan plane për të bashkuar kënetën me detin përmes hapjes së një kanali, i cili do të siguronte qarkullimin e ujit të ëmbël të kënetës që ishte shkak për të gjitha sëmundjet⁴¹ dhe do ta kthente Durrësin në një ishull, gjë që “do t’i vlente shumë shëndetit të atij qyteti”.⁴² Ky projekt u realizua pjesërisht më vonë, më 1446, në kohën e bailkapitenit të Durrësit, Giovanni Contareno, kur u hap një kanal që lidhte ujërat e ëmbla dhe të ndenjura të

³⁶ Klaus Bergdolt, *Der Schwarze Tod: Die Große Pest und das Ende des Mittelalters* (München: C. H. Beck, 2011), 71.

³⁷ Borst, *Lebensformen*, 116.

³⁸ Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1219.

³⁹ Klaus Bergdolt, “Die Pest und die Juden - Mythen, Fakten, Topoi”, në *Aschkenas*, vol. 29, n 3. 1 (2019): 43-62.

⁴⁰ Borst, *Lebensformen*, 116.

⁴¹ *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*, Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Tertia: Saeculi XV Scanderbegianam Periodum complectens. Tomus Undevigesimus (München: Rudolph Trofenik, 1973), nr. 5278, f. 227 (më tej: AAV, XIX); shih edhe Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1218-19.

⁴² *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen II (1344-1406) (Vindobonae: Adophi Holzhausen MXMXVIII), nr. dok. 500 (128); shih edhe Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1219.

kënetës me ujin e detit, por vetëm nga njëri krah.⁴³

Në lidhje me masat profilaktike, të cilat janë të shumta,⁴⁴ për lashtësinë mund të përmendim një rast që gjendet edhe në Bibël. Aty tregohet se profeti Jesaja, për të shëruar Mbretin Hiskija, përdori një lloj qulli të bërë nga fiqtë, me të cilin lyente gjëndrat e sëmura.⁴⁵ Fiqtë këshilloheshin për mjekimin e murtajës edhe nga Plini dhe përdreshin gjithashtu edhe nga mjekët Dioskurides (Antikitët) dhe Ulisse Aldrovandus (shek. XVII).⁴⁶

Në praktikë, bëhej kontrolli i anijeve për minj, sepse ata janë notues të mirë. Për këtë arsye, karrocet dhe mjetet e transportit, në rastin e ndonjë infeksioni nëpër anije, nuk duhej të afroheshin tek mola, pasi nuk përjashtoj mundësia që minjtë të kalonin në këto mjete.⁴⁷ Një praktikë tjetër ishte edhe djegia e sendeve dhe e rrobave të viktimave.⁴⁸ Megjithatë, në shumë raste, rrobat e viktimës përdreshin edhe nga familjarë të tjerë. Deri vonë (shek. XIX) në Perandorinë Osmane ushtarët merrnin rrobat e shokut të tyre të vdekur nga murtaja dhe kështu infektoheshin edhe vetë.⁴⁹

Tani le të kalojmë te rastet e epidemive që historiografia ka regjistruan në trojet iliro-arbërore.

Sëmundja e murtajës në trojet iliro-arbërore nga Antikiteti deri në Mesjetën e Mesme

Murtaja në kohët e lashta dhe në Antikitët

Në këtë punim nuk do të ndalemi te rastet e murtajës që kanë rënë në Greqinë antike, ndonëse ato janë të shumta, por do të përqendrohemi

⁴³ AAV, XIX, nr. dok. 5278 (227); shih edhe Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1219.

⁴⁴ *Profilaksia*, 252-256.

⁴⁵ Isaia 38/ 21; Mbretërit II 20/7, në *Bibla*, 1016, 465.

⁴⁶ Stern, *Medizin*, 265.

⁴⁷ Sheube, "Pest, Bubenpest", 576.

⁴⁸ Xhufi, *Árbërit e Jonit*, 1216; Për sa i përket *profilaksisë së sotme*, përveç karantinës për anijet që vinin nga zona të dyshimta, përdreshin edhe masa të tjera, si: deratizimi, dezinfektimi dhe zhdukja e pleshtave *përmes përdorimit të lëndëve kimike. Për njerëzit përdreshin vaksinat, streptomicina, tetraciklina dhe kloramfenikoli*_etj. Shih më gjerë te: Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 628.

⁴⁹ Stern, *Medizin*, 273.

tek ato raste që mendohet se kanë prekur edhe territoret ilire. Megjithatë, sa u përket teksteve antike që përshkruajnë murtajën, është me interes të përmendim epideminë që ra në Atikë dhe në Athinë gjatë *Luftës së Peloponezisë* (431- 404 para Krishtit). Kjo epidemi, e cila me sa duket zgjati disa vjet – nga viti 430 deri në vitin 426 – dhe mori emrin *Epidemia Atike*, mendohet se ishte murtajë. Ja si e përshkruan me mjeshtëri Tukiditi anarkinë dhe mospërfilljen që u shkaktua nga kjo sëmundje:

“Askush nuk kishte guximin e mjaftueshëm për të luftuar për ato gjëra që vlerësoheshin si të fisme, sepse askush nuk ishte i sigurt, nëse këto gjëra do ta shkonin edhe përtej fundit të tij. Përkundrazi, ajo që ishte e këndshme për çastin dhe, në njëfarë mënyre, fitimprurëse për momentin, vlente si diçka e bukur dhe dobiprurëse. Asnjë frikë nga perënditë, asnjë ligj njerëzor nuk mund t’i ndalonte më njerëzit. Për ta, ishte e parëndësishme nëse këto duhej të nderoheshin apo të respektoheshin, sepse njerëzit po e shihnin se gjithçka po shkatërrohej pa dallim. Për kriminelët nuk jepeshin më ndëshkime, sepse askush nuk shpresonte se do t’ia arrinte ditës së gjyqit kur do të jepej dënimi, ngaqë njerëzit besonin se mbi krerët e tyre tashmë po luhatej një gjykim shumë më i madh që kishte përcaktuar çdo gjë dhe, para shpërthimit të të cilit, ia vlente që ta shijojë sadopak jetën, edhe për aq kohë të shkurtër sa kishte mbetur.”⁵⁰

Tukiditi jep të dhëna edhe për përfshirjen e ilirëve të Jugut (p.sh. fisit të Enkelejve⁵¹) në *Luftën e Peloponezisë*, si në anën e Athinës ashtu edhe në atë të Spartës,⁵² gjë që e përforcon hipotezën e përhapjes së epidemisë edhe në trojet ilire dhe epirote. Pra, nuk përjashtohet mundësia që edhe këto territore të jenë prekur nga kjo sëmundje, edhe për një arsye tjetër: gjatë kësaj lufte u përfshinë edhe territoret e Korfuzit, Thesalisë,

⁵⁰ Përkthyer nga autori i këtij artikulli sipas tekstit në gjuhën gjermane te: Johann Wilhelm Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands vom Anfange geschichtlicher Kunde bis auf unsere Tage*. Erster Theil. (Leipzig: Johann Ambrosius Barth, 1832), 275, ref. 1.

⁵¹ Tukiditi, “Historiae, Libri IV. 126”, në *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, përgatitur nga Selim Islami, Frano Prendi, Hasan Ceka, Skënder Anamali (Tiranë: Toena 2002), 29, ref. 1.

⁵² Po aty, 23.

Maqedonisë, prandaj është e arsyeshme të mendohet se pasojat i kanë vuajtur edhe viset e Epirit.⁵³ Për më tepër, siç pohojnë edhe studiues të ndryshëm, murtaja nuk përhapej vetëm nga anijet tregtare që sillnin në bord njerëz të infektuar dhe minj, por edhe nga trupat ushtarake, të cilat, në mënyrë të vazhdueshme, u bënë bartës dhe përhapës të epidemive gjatë gjithë kohës – madje deri në periudhat më të fundit.

Duke iu referuar Apianit (*Liber de Bellis Illyricis*), Hahn përmend edhe një rast murtaje që kishte rënë mbi fisin e madh ilir të Autariatëve, për shkak se këta kishin marrë pjesë përkrah galëve në fushatën kundër Delfit. Si pasojë, Apolloni i zemëruar u dërgoi atyre murtajën dhe sëmundje të tjera, duke i çuar kështu në prag të zhdukjes.⁵⁴ F. Hoxha përmend raste murtaje që në kohën e Antikitetit të Vonë dhe flet për kërdi murtaje, por edhe për epidemi të ndryshme (si lija), të cilat infektonin krahinat krahas problemeve të tjera (si dyndjet e popujve dhe shthurja e pushtetit qendror) të Perandorisë Romake, ku bënin pjesë edhe trojet ilire.⁵⁵ Një autor tjetër i Antikitetit që përmend praninë e murtajës në Iliri është edhe Plini Plaku (Gaius Plinius Secundus Maior, † 79) i shekullit I të erës sonë, i cili tregon se Hipokrati në trajtimet e tij mjekësore kishte paralajmëruar për ardhjen e një murtaje nga Iliria dhe se i kishte nisur dishepujt e tij nëpër qytetet e prekura, me qëllim që të jepnin ndihmën e tyre.⁵⁶

Një dëshmi tjetër shumë e hershme që përmend këtë sëmundje mendohet se vjen nga mjeku grek Rufus i Efesit, bashkëkohës i Perandorit romak Trajan (98-117). Ai flet për “bubone murtaje, jashtëzakonisht vdekjeprurëse dhe akute” (pestilentes bubones maxima letales et acuti) që ishin vërejtur rreth vitit 200 para Krishtit në Libi, Egjipt dhe Siri.⁵⁷ Mendohet se gjatë kësaj-kohe sëmundja ishte ende në një fazë primitive, pra nuk ishte zhvilluar plotësisht, dhe se popullsitë e

⁵³ Rreth gjeografisë së kësaj lufte shih për më gjerë te: Hermann Kinder & Werner Hilgemann, *Atlante Storico*. Cronologia della storia universale (Milano: Garzanti, 2004), 60-61.

⁵⁴ Hahn, *Albanesische Studien*, Heft II, 332.

⁵⁵ Fejzi Hoxha, *Njoftime mbi zhvillimin e mjekësisë në Shqipëri*. Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë (Tiranë: Mihal Duri, 1962), 7.

⁵⁶ Ardian Muhaj, “Five Centuries of Plague in Albania (Fourteenth to Nineteenth Century)”, në *Hiperboreae*, vol. 11, no. 2 (2024): 154.

⁵⁷ Sheube, “Pest, Bubenpest”, 556.

asaj kohe nuk kishin dendësinë e nevojshme që sëmundja të shndërrohej në një pandemi, gjë që në fakt ngjau 400 vjet më vonë, në shek. VI.⁵⁸

Në kohën e Perandorit Galienus (*Publius Licinus Egnatius Gallienus* 218-268), që në vitet e para të qeverisjes (periudha e qeverisjes 260-268), kemi të dhëna për një pandemi murtaje, e cila duket se përfshiu disa rajone të krahinave lindore të Perandorisë Romake (pra, duke depërtuar edhe nëpër trojet ballkanike në atë kohë të banuara nga ilirët, maqedonasit, grekët, por edhe nga romakët).⁵⁹ Mendohet se vatra e sëmundjes ka qenë në Etiopi, por ajo u ngjiti më sipër duke arritur deri në Ballkan dhe duke bërë kërdi për 15 vjet rresht në të gjitha vendet që preku.⁶⁰

Murtaja gjatë Mesjetës së Hershme

Gjatë viteve 541-542 kemi të dhëna rreth murtajës që bie në Perandorinë Bizantine, e cila shtrihet në të gjitha territoret e saj dhe madje edhe përtej kufijve të perandorisë. Sipas disa autorëve, kjo është dëshmia e parë e saktë për shfaqjen e murtajës bubonike.⁶¹ Vitet 541-542 ishin vala e parë⁶² e kësaj sëmundjeje, e cila do të vazhdonte gjatë gjithë shekullit. Mendohet se sëmundja pati si vatër, ose fillimisht u shtri në Etiopi e më pas në Egjipt dhe, nëpërmjet rrugëve tregtare dhe komunikimit detar, u përhap në të gjithë Mesdheun duke u shtrirë nga Spanja e deri në vendet e tjera perëndimore, ndërsa në Orient arriti deri në Persi e më tej.⁶³ Pra, këtu nuk përjashtohen as trojet iliro-arbërore,⁶⁴ sidomos qytetet portuale në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit, pasi epidemia u përhap valë-valë në të gjithë Perandorinë Romake.⁶⁵ Një gjurmë e saj mendohet se është identifikuar në qytetin e Butrintit ku janë

⁵⁸ Aberth, *Plagues*, 22.

⁵⁹ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands I*, 593.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ Cyril Magno, *La civiltà bizantina* (Milano: Corriere della Sera, 2004), 100.

⁶² Mischa Meier, "The 'Justinianic Plague' - Die, Justinianische Pest": An "Inconsequential Pandemic"? A Reply", në *Medizinhistorisches Journal*, Bd. 55, Heft. 2 (2020): 174.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ Muhaj, "Five Centuries", 154.

⁶⁵ Johannes Koder, "Landwirtschaft beiderseits der Stadtmauern. Konstantinopels Versorgung mit Gemüse aufgrund der *Geoponika*", në *Farming the City, The resilience and the decline of urban agriculture in European History*. Editors: Erich Landsteiner, Tim Soens (Innsbruck: Studien Verlag 2019), 182 (181-199).

zbuluar pesë varre, që i përkasin pikërisht periudhës së përhapjes së kësaj murtaje, në të cilat besohet se janë varrosur viktimat e saj.⁶⁶ Murtaja shpërtheu me gjithë furinë e saj në pranverën e vitit 542, në kryeqytetin e perandorisë, Kostandinopojë. Kërdia që bëri kjo sëmundje ishte e madhe. Sipas Prokopit të Cezareas, dëshmitar okular i ngjarjeve, epidemia zgjati rreth tre muaj, duke shkaktuar fillimisht 5 000 të vdekur në ditë, e më pas deri në 10 000 të vdekur, për të cilët nuk kishte më as vende varrimi.⁶⁷ Kështu u pa e nevojshme që t'i grumbullonin kufomat ose nëpër bregdet, ose në kullat e Sykes (Sycae), në Gallatë. Prej andej, filloi të përhapej në qytet një erë e keqe dhe e rrezikshme, plot sëmundje e vdekje.⁶⁸ Disa vjet më vonë, në vitin 549, gjeti vdekjen nga kjo murtajë edhe vetë Perandori Justiniani I (527-565),⁶⁹ i cili qeverisi pikërisht gjatë kësaj periudhe, dhe flitet se ai u sëmur dhe vdiq nga kjo epidemi. Ndaj sëmundja u quajt më pas *Murtaja e Justinianit*. Epidemia zgjati rreth 50-60 vjet dhe duket se ka qenë e shoqëruar edhe me sëmundjen e lisë.⁷⁰

Valë të kësaj sëmundjeje pati edhe në vitet 555, 558, 561, 573-74, 591, 599 dhe në fillim të shek. VII,⁷¹ pra gjatë gjithë Mesjetës së Hershme. Kjo epidemi e shek. VI, duket se ka fshirë nga faqja e dheut gjysmën e popullsisë së Europës.⁷² Në vitin 618, në kohën e Perandorit Heraklios, Perandoria Bizantine u godit nga një tjetër epidemi e fuqishme, duke bërë kërdi veçanërisht në Kostandinopojë.⁷³ Megjithatë, nuk disponojmë të dhëna të sakta mbi përmasat e saj, shtrirjen dhe

⁶⁶ David Hernandes, Dhimitër Çondi, "Forumi në Butrint", në *Iliria* XXXVI (2012): 422.

⁶⁷ "Tre mesi bastò il male in. Bizanzio, e non molte per verità erano da principio le vittime sue, ma di poi crebbero per ciaschedun giorno sino a cinque e ben di frequente a dieci mila, nel quale numero aveanvi molti ricchi spenti meglio dalla mancanza di chi ministrasse loro gli. opportuni rimedj, non sopravvivendone più alcuno, che non dalla gagliardia del male, e degli estinti gran copia rimaneva insepolta.", Opere di Procopio di Cesarea, Secondo Tomo: *Istoria delle Guerre Persiane e Vandaliche*, Nuova traduzione con note di Giuseppe Rossi (Milano: Coi Tipi di Andrea Molina, 1833), 240.

⁶⁸ Magno, *La civiltà bizantina*, 100.

⁶⁹ Opere di Procopio di Cesarea, II, 237.

⁷⁰ Sheube, "Pest, Bubenpest", 556.

⁷¹ Magno, *La civiltà bizantina*, 100; shih edhe: Muhaj, "Five Centuries", 153.

⁷² Muhaj, "Five Centuries", 153.

⁷³ Gustav Friedrich Hertzberg, *Geschichte Griechenlands seit dem Absterben des antiken Lebens bis zur Gegenwart*. Erster Theil: Vom Kaiser Arkadius bis zum lateinieschen Kreuzzuge (Gotha: Friedrich Andreas Perthes, 1876), 148.

kohëzgjatjen e epidemisë. Për sa i përket shek. VIII kemi të dhëna për një murtajë që ra gjatë viteve 741-775 në Greqi.⁷⁴ Kjo murtajë, e cila në vitin 746 kishte prekur një sipërfaqe të madhe të globit, bëri kërdi në popullsinë e Perandorisë Bizantine, sidomos në Kostandinopojë.⁷⁵ Nuk përjashtohet mundësia që kjo sëmundje të ketë rënë edhe në temat bizantine të trojeve arbërore, të cilat, ashtu si territoret helene, po përjetonin tashmë edhe një dyndje të madhe sllavësh, ngulmimet e të cilëve në Ballkan u bënë gjithnjë e më të shpeshta, edhe për shkak të zbrazjes së vendit nga sëmundja. Me sa duket, kjo valë e re murtaje erdhi nga Sicilia dhe Kalabria, duke u përhapur me shpejtësi fillimisht në Monemvazia dhe nëpër ishujt përreth, e më pas u shtri edhe në të gjithë perandorinë,⁷⁶ pikërisht gjatë kohës së Perandorit Konstantin V, i cili qeverisi në periudhën ndërmjet viteve 741-775.

Murtaja gjatë Mesjetës së Mesme

Në vitin 1065, në kohën e Perandorit Konstantin Dukas, kemi të dhëna për një shpërthim murtaje në Maqedoni, e cila, me sa duket, u soll nga kalorësia e oguzëve (në burimet bizantine *uzët* [Ούζοι]), një degë e peçenegëve. Këta depërtuan përmes Bullgarisë dhe Trakisë dhe mbërritën deri në Maqedoni, duke kërcënuar edhe qytetin e Selanikut.⁷⁷ Kjo turmë e uzëve, e cila ishte larguar nga vendi i vet për shkak të murtajës, ishte aq e madhe, sa thuhej se përbëhej nga rreth 600 000 burra të armatosur e të gatshëm për luftë, dhe kudo ku kalonin, shkretonin dhe plaçkitnin gjithçka që gjenin përpara. Pasi ushtria e tyre u shpërnda, një pjesë e uzëve kërkoi mbrojtjen e perandorit dhe u vendos në Maqedoni; ata përfituan vendbanime dhe u bënë nënshtetas të perandorisë.⁷⁸ Se cilat lokalitete preku kjo murtajë, të dhënat që disponojmë nuk mjaftojnë për të paraqitur një gjeografi të saktë të përhapjes së saj. Megjithatë, kërcënimi i Selanikut, qytet i afërt me trojet arbërore dhe kryeqendër e Maqedonisë, i cili frekuentohej shpesh nga arbitri – krijon një hipotezë të fortë se sëmundja mund të jetë përhapur edhe në Arbëri.

⁷⁴ Kenneth M. Setton, "The Bulgars in the Balkans and the Occupation of Corinth in the Seventh Century", në *Speculum*, vol. 25, nr. 4 (October 1915): 510.

⁷⁵ Po aty, 511.

⁷⁶ Po aty, 532, ref. 73.

⁷⁷ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 821.

⁷⁸ Po aty, 822.

Në vitet '90 të shek. XI kemi të dhëna për një murtajë që kishte rënë gjatë luftës së Normanëve nën udhëheqjen e Guiskard-it dhe djemve të tij, Beomund dhe Roxher, kundër Perandorisë Bizantine. Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve, veçanërisht gjatë luftës për pushtimin e Durrësit në vitin 1081 kemi gjithashtu të dhëna për një epidemi, e cila, me shumë gjasë, ishte murtaja që duhet të ketë rënë në verën e këtij viti.⁷⁹ Sëmundja ra mbi trupat normane, radhët e të-cilave u pakësuan shumë, jo vetëm për shkak të epidemisë, por edhe për shkak të mungesës së ushqimeve.

Sipas Zinkeisen-it, viktimat e kësaj murtaje të tmerrshme ishin dhjetë mijë trupa të ushtrisë së Guiskard-it, ndër to edhe pesëqind kalorës të përzgjedhur normanë.⁸⁰ Për sa u përket viktimave që shkaktoi sëmundja brenda Durrësit, autorët e cituar nuk japin të dhëna të detajuara.

Megjithatë, Guiskard e mblodhi veten, riorganizoi ushtrinë dhe, më 15 tetor 1081, i dha një goditje ushtrisë së Perandorit Aleksios I. Ky i fundit, u shfaq me ushtri përballë Guiskard-it para mureve të Durrësit, në afërsi të një kishe që përmendet si "Kisha e Shën Kollit". Më 18 tetor të atij viti, në të njëjtën fushë ku dikur ishte zhvilluar edhe beteja e njohur ndërmjet Cezarit dhe Pompeut, ushtria perandorake pësoi goditjen kryesore. Këtu po hapim një parantezë, me qëllim që të japim një përshkrim më të zgjeruar të kësaj beteje para mureve të Durrësit, ku ishte e pranishme edhe murtaja. Në betejë u plagos edhe vetë Aleksi I, i cili shquhej për trimërinë e tij. Me vështirësi ai arriti të shpëtonte dhe u nis për në Devoll; prej andej shkoi në Ohër, dhe më pas në Selanik për të riorganizuar forcat.⁸¹ Fitorja e ushtrisë së Guiskard-it, e decimuar nga murtaja, ishte e shkëlqyer. Në saje të guximit të tij të palëkundshëm, Guiskard – me një ushtri të rraskapitur, por që tregoi një vendosmëri të patundur dhe një rezistencë të jashtëzakonshme – arriti të fitonte kundër ushtrisë së Perandorit Aleks, e cila ishte e armatosur mirë dhe përbëhej prej rreth shtatëdhjetë mijë trupash.⁸² Megjithatë, Durrësi nuk ishte pushtuar ende.

Guiskard vazhdoi ta mbante Durrësin të rrethuar. Më 14 shkurt të vitit 1082, normanët arritën të merrnin një nga kullat e qytetit me anë të tradhtisë. Tri ditë më vonë, pas luftimesh të ashpra nëpër rrugicat e qytetit, ata e pushtuan atë plotësisht. Një venedikas i quajtur Domenico, i

⁷⁹ Hertzberg, *Geschichte*, 353.

⁸⁰ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 828.

⁸¹ Hertzberg, *Geschichte*, 353.

⁸² Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 828.

cili sipas burimeve kishte zili ndaj të birit të doxhit të Venedikut – që me sa duket mbante një detyrë kyçe në mbrojtjen e Durrësit – tradhtoi dhe ua dorëzoi normanëve kullën e rëndësishme, përmes së cilës ata depërtuan brenda qytetit.⁸³ Kështu, Durrësi – i rrskapitur nga rrethimi, luftimet dhe pa dyshim edhe nga murtaja që e kishte goditur më parë – ra në duart e normanëve përmes tradhtisë.⁸⁴

Komandanti i përgjithshëm për mbrojtjen e Durrësit kishte qenë shqiptari Komiskortis. Normanët më parë, nën udhëheqjen e Beomund-it, kishin arritur të pushtonin edhe Orikumin, Vlorën dhe Kaninën, dhe kishin hedhur sytë drejt Butrintit e Korfuzit.⁸⁵ Sigurisht, epidemia që kishte rënë gjatë kësaj kohe duhet të ketë pasur pasoja edhe më të rënda, përveç rrallimit të trupave normane, por për këtë çështje historiografia hesht – ose të paktën, nga literatura që kemi në dispozicion, nuk jepen të dhëna të tjera. Pas pushtimit të Durrësit, Guiskard u drejtua në Jug, ku pushtoi Kosturin dhe më pas synonte të pushtonte edhe Selanikun. Megjithatë, ai u detyrua të largohej nga Ballkani, pasi territoret papnore në Itali po kërcënoheshin nga trupat gjermane nën Perandorin Henrik IV.⁸⁶ Në Durrës dhe në territoret e pushtuara, Guiskard la të birin, Beomund-in me një grup ushtarësh të sprovuar për t'i mbrojtur ato.

Në vitin 1083 kemi të dhëna edhe për një tjetër murtajë që përfshiu territore të tëra të Perandorisë Bizantine dhe mbërriti deri në trojet arbërore. Epidemia, me sa duket, preku edhe Vlorën, Butrintin dhe Korfuzin, edhe gjatë vitit 1084.⁸⁷ Gjatë kësaj kohe, kur murtaja kishte përfshirë të gjithë Epirin, ushtria normane – e cila mbante të pushtuara krahina të tëra – filloi të shfaqte pakënaqësi për shkak të rrogave të vonuara dhe të papaguara. Një pjesë e ushtarëve kaluan në anën e perandorit, pasi kuptuan se Beomund nuk mund t'i realizonte kërkesat e tyre.⁸⁸ Kështu, Princit Beomund nuk i mbeti zgjidhje tjetër veçse të largohej nga Kosturi, ku po qëndronte për momentin, dhe të nisej për në Vlorë, me qëllim që të lajmëronte të atin, Guiskard-in, që t'i sillte para të mjaftueshme për ushrinë. Por sapo ai u largua, kështjella e Kosturit u ripushtua nga Aleksios. Vështirësitë që iu krijuan Beomund-it e detyruan

⁸³ Hertzberg, *Geschichte*, 353.

⁸⁴ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 828.

⁸⁵ Hertzberg, *Geschichte*, 351.

⁸⁶ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 829.

⁸⁷ Hertzberg, *Geschichte*, 357.

⁸⁸ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 829.

atë që të tërhiqej fillimisht në Arbëri, e më pas të kthehej tek i ati në Salerno, i cili e priti të birin me dinjitet, por jo pa dhimbje, kur dëgjoi lajmet e këqija që Beomund solli.⁸⁹

Guiskard vendosi të hakmerrej personalisht për këtë turp. Ai mblodhi ushtrinë në Tarent dhe, me anije të mëdha transportuese, e solli atë në Vlorë gjatë shtatorit të vitit 1084. Aty u bashkua edhe me trupat e Beomund-it dhe të djalit tjetër, Roger-it, të cilët ishin kthyer më përpara në Ballkan dhe kishin pushtuar sërish Vlorën pa hasur asnjë rezistencë.⁹⁰ Në nëntor, pasi mbërriti në Butrint, Guiskard arriti që të shtinte në dorë të gjithë ishullin e Korfuzit, pas disa fitoreve që kishte shënuar më parë kundër flotës veneciano-greke. Por fati nuk ishte më në anën e tij. Ushtria normane, e shpërndarë nëpër vendstrehimet dimërore, u godit rëndë nga murtaja, e cila për tre muaj bëri kërdi duke vrarë më tepër se 10 000 trupa dhe 500 kalorës.⁹¹ Vetë Guiskard vdiq më vonë, më 17 korrik 1085, ditën e Shën Lukës, në moshën 70-vjeçare po nga murtaja. Burimi thotë se shkaku i vdekjes së tij ishte një ethe e fortë. Lidhur me vendin e saktë të vdekjes, thuhet se mund të ketë qenë qyteti Kasiopea në Korfuz, ose Qefalonia, ku ndodhej edhe një port me emrin Porto Viskardo. Me vdekjen e Guiskard-it rreziku norman u largua. Ushtria normane që mbante ende të pushtuar Durrësin ia shiti qytetin Perandorit Aleksios I dhe më pas u largua, kurse pjesët e mbetura të ushtrisë nëpër lokalitetet e tjera bregdetare të pushtuara të Adriatikut u futën nën shërbimin bizantin.⁹² Me sa duket, shpërbërja e ushtrisë normane pas vdekjes së Robert Guiskard-it ndodhi edhe për shkak të mosmarrëveshjeve midis djemve të tij, Beomund-it dhe Roxher-it, të cilët nuk ditën të ecnin në rrugën e fitores dhe të lavdisë që ua kishte shtruar më parë ati i tyre.⁹³ Pra, siç e pamë edhe më sipër, pothuaj gjatë gjithë kësaj periudhe që normanët sulmonin trojet arbërore – të cilat ishin pjesë e Perandorisë Bizantine – murtaja duket se ishte vazhdimisht e pranishme: herë e dukshme dhe herë e fshehtë.

⁸⁹ *Po aty.*

⁹⁰ *Po aty.*

⁹¹ Hertzberg, *Geschichte*, 357.

⁹² *Po aty.*

⁹³ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 830.

Përfundime

Si përfundim, mund të thuhet se murtaja, si asnjë sëmundje tjetër, ka shkaktuar shfarosje masive të popullsisë botërore pothuajse gjatë gjithë historisë së njerëzimit që nga lashtësia e deri në ditët e sotme.⁹⁴ Në Mesjetë, murtaja konsiderohej si “armiku më i rrezikshëm dhe më i pamëshirshëm” i njerëzimit. Bazuar në të dhënat e paraqitura më sipër, mund të përmendim disa nga arsyet kryesore pse kjo sëmundje konsiderohet si armiku numër një i kësaj periudhe. Këto arsye janë:

- *Vdekshmëri e lartë*: Murtaja çoi në një ulje dramatike të popullsisë. Vlerësohet se një e treta deri në gjysmën e popullsisë europiane,⁹⁵ apo një e katërta e popullsisë globale⁹⁶ humbën jetën brenda disa vjetëve, veçanërisht gjatë “Vdekjes së Zezë” (1347-1351);

- *Përhapje e shpejtë*: Sëmundja përhapej me shpejtësi, sidomos nëpërmjet rrugëve tregtare, nëpër qytete me dendësi të lartë të popullsisë e përtej, duke shkaktuar panik dhe kaos social të paprecedent;

- *Ndikime të thella shoqërore dhe ekonomike*: Murtaja shkaktonte kolaps të strukturave sociale, mungesë të fuqisë punëtore dhe stanjacion ekonomik. Rënia drastike e popullsisë çonte në ndryshime shoqërore dhe shndërrime të thella;

- *Pasoja negative afatgjata*: Ndikimi i murtajës mbi shoqërinë europiane – duke përfshirë edhe atë arbërore – ishte afatgjatë dhe i thellë. Ajo solli ndryshime të mëdha në ekonomi, në planifikimin urban, në shtresëzimin shoqëror, duke krijuar një përbërje të re shoqërore, të ndryshme nga ajo që ekzistonte më parë;

- *Mungesa e njohurive*: Gjatë lashtësisë, Mesjetës por edhe më vonë njohuritë mjekësore ishin të kufizuara dhe shpesh të pasakta. Shkaqet dhe rrugët e transmetimit të murtajës ishin të panjohura, si rrjedhojë keqinformimet ishin nga më të ndryshmet dhe me pasoja të rënda.

Në këtë kontekst, murtaja mund konsiderohet si *armiku më vdekjeprurës dhe më i frikshëm* i Mesjetës, me një ndikim të thellë e të gjerë mbi botën e atëhershme.

⁹⁴ Fatturoso & Ritter, *Vademekum*, 627.

⁹⁵ William H. McNeill, *Plague and Peoples* (Garden City (New York): Anchor Press, 1976), 149.

⁹⁶ Sheube, “Pest, Bubenpest”, 556; Muhaj, “Five Centuries”, 153.

Për sa u përket të dhënave rreth *sulmeve* të kësaj sëmundjeje në trojet ilire, si përfundim mund të thuhet se ato janë jashtëzakonisht të pakta. Kjo mungesë e të dhënave për historinë e-ilirëve është shumë e madhe dhe prek jo vetëm *historinë e sëmundjeve*, por përfshin edhe çdo aspekt të jetës së tyre. Megjithatë, u përpoqëm të gjenim disa të dhëna, të cilat i kemi vjelë me vështirësi për shkak të problematikës së lartpërmendur dhe mungesës së burimeve.

- Së pari, është me interes të përmendim epideminë që goditi rëndë Atikën dhe Athinën gjatë *Luftës së Peloponezitet* (431-404 para Krishtit), e njohur si *Epidemia Atike* e cila zgjati për disa vjet (430-426).⁹⁷ Tukidi jep të dhëna edhe për përfshirjen e ilirëve të Jugut (të fisit të Enkelejve⁹⁸) në këtë luftë, si në anën e Athinës ashtu edhe në atë të Spartës,⁹⁹ gjë që e përforcon hipotezën e përhapjes së epidemisë edhe në trojet iliro-epirote. Pra, nuk përjashtohet mundësia që edhe këto territore të jenë prekur nga epidemia, edhe për një arsye tjetër: gjatë kësaj lufte u përfshinë edhe territoret e Korfuzit, Thesalisë, Maqedonisë, prandaj është e arsyeshme të mendohet se pasojat i kanë vuajtur edhe viset e Epirit.

- Një tjetër rast është edhe ai i murtajës që goditi fisin e madh ilir të Autariatëve, kur këta morën pjesë përkrah galëve në fushatën kundër Delfit. Si pasojë – siç thotë Hahn – “Apolloni i zemëruar” u dërgoi atyre murtajën dhe sëmundje të tjera, duke i çuar kështu në prag të zhdukjes.¹⁰⁰

- Një autor tjetër i Antikitetit që shkruan për praninë e murtajës në Iliri është edhe Plini Plaku († 24 tetor 79). Ai tregon se si Hipokrati në trajtesat e tij mjekësore kishte paralajmëruar për rënien e një murtaje të ardhur nga Iliria dhe se i kishte nisur dishepujt e tij nëpër qytetet e prekura, me qëllim që të ofronin ndihmën e tyre.¹⁰¹

- Rasti i fundit që arritëm të eidentojmë në burimet e Antikitetit është ai gjatë kohës së Perandorit Galienus (*Publius Licinus Egnatius Gallienus* 218-268), i cili përmend një pandemi murtaje qysh në vitet e para të qeverisjes. Kjo pandemi përfshiu disa rajone të krahinave lindore të Perandorisë Romake (përfshirë edhe Ballkanin, në atë kohë të banuar nga ilirë, maqedonas grekë, por edhe nga romakë), duke bërë kërdi për

⁹⁷ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands I*, 275, ref. 1.

⁹⁸ Tukiditi, “*Historiae*, Libri IV. 126”, 29, ref. 1.

⁹⁹ Po aty, 23.

¹⁰⁰ Hahn, *Albanesische Studien*, Heft II, 332.

¹⁰¹ Muhaj, “Five Centuries”, 154.

afro 15 vjet rresht.¹⁰² Si përfundim, mund të themi se këto janë rastet e murtajes të dokumentuara në trojet ilire që arritëm të gjenim deri tani, edhe pse hulumtimi ynë është bazuar në një literaturë të gjerë dhe në revista shkencore, të cilat fatkeqësisht nuk na ofruan një qasje më të thelluar e të plotë.

Edhe për sa i përket Mesjetës së Hershme, ka një mungesë të madhe dokumentesh dhe materialesh dhe, si rrjedhojë, është e pamundur të paraqitet një histori, qoftë edhe e përgjithshme, si për murtajen, ashtu edhe për fusha të tjera. Periudha e Mesjetës së Hershme njihet në historiografi si *epoka e gjysmëmijëvjeçarit të errët* që u shkaktua kryesisht nga *dyndja e popujve*, e cila në shumë vende solli me vete edhe shkatërrimin e burimeve historike.

- Si rast i parë i murtajes përmenden vitet 541-542, kur sëmundja bie në Perandorinë Bizantine dhe shtrihet në të gjitha territoret e saj e përtej. Gjatë kësaj periudhe kemi edhe të dhënat e para të sakta rreth shfaqjes së murtajes bubonike.¹⁰³ Sëmundja u përhap në të gjithë Mesdheun, duke mos përjashtuar as trojet iliro-arbërore,¹⁰⁴ sidomos qytetet portuale në Adriatik dhe në Jon. Një gjurmë e saj është identifikuar edhe në qytetin e Butrintit, ku janë zbuluar pesë varre kolektive që i përkasin pikërisht kohës së përhapjes së kësaj murtaje dhe që besohet se janë varrosur viktimat e saj.¹⁰⁵ Murtaja shpërtheu në pranverën e vitit 542 fillimisht në kryeqytetin e perandorisë, Kostandinopojë, duke shkaktuar me mijëra të vdekur në ditë. Disa vjet më vonë, më 549, vdiq nga kjo epidemi edhe vetë Perandori Justiniani I.¹⁰⁶ Si rrjedhojë, sëmundja mori edhe emrin *Murtaja e Justinianit*. Epidemia zgjati rreth 50-60 vjet dhe u shoqërua edhe me sëmundjen e lisë.¹⁰⁷

- Valë të sëmundjes pati edhe gjatë gjithë shek. VI dhe në fillim të shek. VII, duke fshirë nga faqja e dheut gjysmën e popullsisë së Europës.¹⁰⁸ Për sa i përket shek. VIII, kemi të dhëna për një murtaje në vitet 741-775 që bëri kërdi në popullsinë e Perandorisë Bizantine,

¹⁰² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands I*, 593.

¹⁰³ Magno, *La civiltà bizantina*, 100.

¹⁰⁴ Muhaj, "Five Centuries", 154.

¹⁰⁵ Hernandes & Çondi, "Forumi në Butrint", 422.

¹⁰⁶ Opere di Procopio di Cesarea, II, 237-240.

¹⁰⁷ Sheube, "Pest, Bubenpest", 556.

¹⁰⁸ Magno, *La civiltà bizantina*, 100; Muhaj, "Five Centuries", 153.

sidomos në Kostandinopojë.¹⁰⁹ Nuk përjashtohet mundësia që kjo sëmundje të ketë rënë edhe në temat bizantine të trojeve arbërore, të cilat, ashtu si territoret helene, po përjetonin tashmë edhe një dyndje të madhe sllavësh, ngulmimet e të cilëve nëpër Ballkan u bënë gjithnjë e më të shpeshta, edhe për shkak të zbrazjes së vendit nga sëmundja.

- Edhe për Mesjetën e Mesme kemi arritur të gjejmë disa të dhëna; megjithatë, duhet theksuar se edhe kjo periudhë karakterizohet nga një mungesë e theksuar burimesh lidhur me historinë e trojeve arbërore. Si rast të parë të murtajes në këtë epokë përmendet ajo e vitit 1065. Murtaja ra fillimisht në Maqedoni, e sjellë nga kalorësia e oguzëve (uzëve), të cilët depërtuan nëpër Bullgari dhe Traki dhe mbërritën deri në Maqedoni, duke kërcënuar edhe qytetin e Selanikut.¹¹⁰ Se cilat lokalitete preku kjo murtajë, të dhënat që disponojmë nuk mjaftojnë për të paraqitur një gjeografi të saktë të përhapjes së saj. Megjithatë, kërcënimi i Selanikut, qytet i afërt me trojet arbërore dhe kryeqendër e Maqedonisë, i cili frekuentohej shpesh edhe nga arbitri – krijon një hipotezë të fortë se sëmundja mund të jetë përhapur edhe në Arbëri.

- Në vitet '90 të shek. XI kemi të dhëna për një murtajë që kishte rënë gjatë luftës së Normanëve nën udhëheqjen e Guiskardit dhe djemve të tij, Beomund-it dhe Roxher-it, kundër Perandorisë Bizantine. Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve, sidomos gjatë luftës për pushtimin e Durrësit në vitin 1081 kemi gjithashtu të dhëna për një epidemi që duhet të ketë rënë në verën e këtij viti,¹¹¹ e cila preku edhe vetë qytetin e Durrësit. Literatura që disponojmë përmend si viktima të saj dhjetë mijë trupa të Guiskard-it, ndër to edhe pesëqind kalorës të përzgjedhur normanë.¹¹² Për sa u përket viktimave që shkaktoi sëmundja brenda qytetit të Durrësit, nuk jepen të dhëna të detajuara.

- Në vitin 1083 raportohet edhe për një tjetër murtajë që përfshiu territore të tëra të Perandorisë Bizantine dhe mbërriti deri në trojet arbërore. Epidemia, me sa duket, preku edhe Vlorën, Butrintin dhe Korfuzin edhe gjatë vitit 1084.¹¹³ Gjatë periudhës së kësaj murtaje që përfshiu gjithë Epirin,¹¹⁴ ajo infektoi sërish edhe ushtrinë e Guiskard-it

¹⁰⁹ Setton, "The Bulgars", 510-511.

¹¹⁰ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 821.

¹¹¹ Hertzberg, *Geschichte*, 353.

¹¹² Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 828.

¹¹³ Hertzberg, *Geschichte*, 357.

¹¹⁴ Zinkeisen, *Geschichte Grichenlands I*, 829.

dhe për tre muaj bëri kërdi duke vrrarë më tepër se 10 000 trupa dhe 500 kalorës.¹¹⁵ Vetë Guiskard vdiq më vonë, më 17 korrik 1085, në moshën 70-vjeçare po nga murtaja, ose në Kasiopea të Korfuzit, ose në Qefaloni. Pothuaj gjatë gjithë kësaj kohe, ndërsa normanët sulmonin trojet arbërore që ishin pjesë e Perandorisë Bizantine, murtaja duket se ishte vazhdimisht e pranishme: herë e dukshme dhe herë e fshehtë. Këto pra janë të dhënat që arritëm të hulumtojmë mbi murtajën – sëmundjen më të rëndë që ka goditur njerëzimin, sidomos gjatë Mesjetës.

Burime e bibliografi:

Botime dokumentare:

- ACTA Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV.* Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Tertia: Saeculi XV Scanderbegianam Periodum complectens. Tomus Undevigesimus. München: Rudolph Trofenik 1973.
- ACTA et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia.* Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343). Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen.
- BIBLA.* Përktheu dhe shtjelloi dom Simon Filipaj. Ferizaj: Drita 1994.
- TUKIDITI “Historiae, Libri IV. 126”. *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë.* Përgatitur nga Selim Islami, Frano Prendi, Hasan Ceka, Skënder Anamali. Tiranë: Toena, 2002.

Literaturë:

- ABERTH, John. *Plagues in world history.* Lanham/ Boulder/ New York/ Toronto/ Plymouth: Rowman & Littlefield Publishers 2011.
- BERGDOLT, Klaus. *Der Schwarze Tod: Die Große Pest und das Ende des Mittelalters.* 3. Auflage. München: C. H. Beck 2011.
- BERGDOLT, Klaus. “Die Pest und die Juden - Mythen, Fakten, Topoi”, *Aschkenas*, vol. 29, nr. 3. (1/ 2019): 43-62.
- CESAREA, Procopio di. *Istoria delle Guerre Persiane e Vandaliche.* Secondo Tomo. Nuova traduzione con note di Giuseppe Rossi. Milano: Coi Tipi di Andrea Molina 1833.

¹¹⁵ Hertzberg, *Geschichte*, 357.

- ENCYCLOPEDIA of Pestilence, Pandemics, and Plagues*. Volume 1 (A-M). Edited by Joseph P. Byrne. Westport/ Connecticut/ London: Greenwood Publishing Group 2008.
- ENCYCLOPEDIA of Plague and Pestilence: from ancient times to the present*. George Childs Kohn, editor. 3rd ed. New York: Infobase Publishing 2008. 31.
- FJALOR i gjuhës shqipe*. Hartuar nga Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Thanas Feka, Valter Memisha, Artan Goga. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006.
- HAHN, Johan Georg von. *Albanesische Studien*. Jena: Friedrich Mauke, 1854.
- HERNANDES, David & ÇONDI, Dhimitër. “Forumi në Butrint”. *Iliria* XXXVI (2012).
- HOXHA Fejzi. *Njoftime mbi zhvillimin e Mjekësisë në Shqipëri*. Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë. Tiranë: Mihal Duri, 1962.
- HRABAK, Bogumil. “Čuma u Herceg-Novom i na Cernogorskom Promorju u XVI, XVII, i XVIII veku”. *Boka* 15-16 (1984): 115-129.
- JIREČEK, Constantin. *Geschichte der Serben*. Erster Band (bis 1371). Gotha: Perthes 1911.
- KËRÇIKU, Kadri. *Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XX*. Kontribut për historinë e përgjithshme të mjekësisë në Shqipëri. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës 1962.
- KINDER, Hermann & Hilgeman, Werner. *Atlante Storico*. Milano: Garzanti 2004.
- KODER, Johannes. “Landwirtschaft beiderseits der Stadtmauern. Konstantinopels Versorgung mit Gemüse aufgrund der *Geoponika*”. *Farming the City, The resilience and the decline of urban agriculture in European History*. Editors: Erich Landsteiner & Tim Soens. Innsbruck: StudienVerlag, 2019.
- LALA, Etleva. “Klerikët shqiptarë gjatë Mesjetës në arkivat e Dubrovnikut. Arratisjet nga Shqipëria dhe Karriera në qytetet e Bregdetit Dalmat. Zbulime befasuese nga Arkivat e Dubrovnikut.” *Rilindasi*, viti III/Nr. 10, 10 mars 2013.
- MAGNO, Cyril. *La civiltà bizantina*. Milano: Corriere della Sera 2004.
- MCNEILL, William H. *Plague and Peoples*. Garden City (New York): Anchor Press 1976.
- MEIER, Mischa. “The ‘Justinianic Plague’ – Die, Justinianische Pest”: An “Inconsequential Pandemic”? A Reply”. *Medizinhistorisches*

- Journal*, Bd. 55, Heft. 2 (2020).
- MUHAIJ, Ardian. "Five Centuries of Plague in Albania (Fourteenth to Ninteenth Century)". *Hiperboreae*, vol. 11, no. 2 (2024): 151-170.
- FATTORUSSO, Vittorio & Ritter, Otto. *Vademekum Mjekësor për praktikën klinike*. Përkthyer nga Stefan Cilka, Petro Roçi, Luigj Benusi, Raif Hasani, Shyqyri Basha, Qazim, Vasil Bakalli, Xhoxhi Jani. Tiranë: Naim Frashëri 1970.
- OSWALD, Brendan Patrick Claude. "Citizenship in Medieval Ioaninna". *Citizenship in Historical Perspective*. Edited by Steven G. Ellis, Guðmundur Hálfðanarson and Katherine Isaacs. Pisa: Pisa University Press 2006.
- PROFILAKSIA e sëmundjeve ngjitëse të njeriut. Përktheu dr. Stefan Cilka. Tiranë: Shtëpia botuese e librit politik, 1973.
- SCHEUBE, B. "Pest, Bubenpest". *Real-Encyclopädie der gesamten Heilkunde*. Medicinisch-chirurgisches Handwörterbuch für praktische Aerzte. Hrsg. von Albert Eulenburg. Dritte, gänzlich umgearbeitete Auflage. 18. Band. Berlin/Wien: Urban & Schwarzenberg 1898.
- SETTON, Kenneth M. "The Bulgars in the Balkans and the Occupation of Corinth in the Seventh Century". *Speculum*, vol. 25, nr. 4 (October 1915).
- STERN, Bernhard. *Medizin, Aberglaube und Geschlechtsleben in der Tzin, Aberglaube und Geschlechtsleben in der Türkei*. Mit Berücksichtigung der Moslimischen Nachbarländer und der ehemaligen Wasallenstaaten. Berlin: H. Barsdorf 1903.
- ŠUFFLAY, Milan von. "Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme". *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Konstantin Jireček, Milan von Šufflay, Theodor Ippen, E. C. Sedlmayr, Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, Béla Péch, Karl Thopia. Zusammengestellt von Ludwig von Thallóczy. I. Band. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916.
- ŠUFFLAY, Milan. *Srbi i Arbanasi (Njihova simbioza u srednjem vijeku)*. Sa predgovorom St. Stanojevića. Beograd: 1925.
- XHUFI, Pëllumb, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVII*. Tiranë: Onufri 2016.
- ZINKEISEN, Johann Wilhelm. *Geschichte Griechenlands vom Anfange geschichtlicher Kunde bis auf unsere Tage*. Erster Theil: Das Alterthum und die mittleren Zeiten bis zu dem Heerzuge König Rogers von Sicilien nach Griechenland. Leipzig: Barth 1832.

PROF. ASOC. DR. EDMOND MALAJ

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

edmond.malaj@asa.edu.al

*S u m m a r y***ABOUT THE PLAGUE IN THE ILLYRIAN-ALBANIAN TERRITORIES AND AROUND, FROM ANTIQUITY TO THE HIGH MIDDLE AGES**

The plague was an invisible enemy that struck unpredictably, devastating villages and cities and often drastically reducing entire national populations. This article examines the plague as one of the most serious challenges faced by the Balkans, Albanian territories, and other parts of Europe. While several foreign and Albanian scholars - including B. Hrabak, K. Kërçiku, P. Xhufi, and A. Muhaj - have addressed the plague in the Albanian lands, their research primarily focuses on the 15th century and the period of the Ottoman conquest. The novelty of this article lies in its focus on earlier periods: Antiquity, the Early Middle Ages, and the High Middle Ages. Our study is based on existing historiographical literature and a limited number of historical documents available for these earlier periods. We explore cases of plague in the Illyrian-Albanian territories as well as in neighboring regions, from antiquity through the 11th century. The article is divided into two parts. The first provides a general overview of the disease's symptoms and prevention (anamnesis and prophylaxis), contextualized with historical examples from both Albanian territories and neighboring regions. The second part examines specific historical events linked to outbreaks of the disease. This article represents our initial contribution to the study of plague in Albanian history and will be followed by further research.

Key words: Plague, Roman Empire, Justinians Plague, Byzantine Empire, Illyria, Albania, Durrës, Vlora, Butrint.

